Kronikë

# Kishte kultivuar kanabis në pyll, arrestohet 63-vjeçari në Gramsh! Në kërkim i biri (EMRI)

*Një 63-vjeçar në Gramsh u vendos në pranga pasi u kap në flagrancë duke u kujdesur për 35 bimë kanabisi të mbjella në pyllin e fshatit Grazhdan.*




Redaksia
24 Qershor, 14:23 | **Përditesimi: 24 Qershor, 14:39**

Share

Gramsh- Një 63-vjeçar në Gramsh u vendos në pranga pasi u kap në flagrancë duke u kujdesur për 35 bimë kanabisi të mbjella në pyllin e fshatit Grazhdan.

Gjatë kontrollit në banesën e Myrtezan Hoxhës blutë gjetën dhe sekuestruan dy armë gjahu, dy radio të ngjashme me ato të Policisë dhe municion luftarak, të gjitha pa leje.

Ndërkohë në kërkim u shpall edhe djali i tij, 33 vjeç, i dyshuar për bashkëpunim në kultivim të bimëve narkotike.



LEXO EDHE:
**Hotel, bar e restorant! Konfiskohet pasuria e Arjan Kamanit në Cërrik, i dënuar në Bruksel për prostitucion**

Bimët u asgjësuan, ndërsa materialet procedurale i kaluan Prokurorisë së Elbasanit për veprat penale të lidhura me drogën dhe armëmbajtjen pa leje.

**Njoftimi i policisë**

*Si rezultat i një hetimi njëmujor, të ndjekur me metoda proaktive, në bashkëpunim me Prokurorinë e Elbasanit, kundër veprimtarisë kriminale të kultivimit të bimëve narkotike, shërbimet e Komisariatit të Policisë Gramsh finalizuan operacionin policor të koduar "Survejimi".*

*Gjatë operacionit u arrestua në flagrancë, teksa kujdesej për 35 bimët narkotike që kishte kultivuar në pyllin e fshatit ku banonte, shtetasi M. H., 63 vjeç.*

*Më tej, gjatë operacionit u krye kontroll në banesën e këtij shtetasi, ku u gjetën 2 armë gjahu, 2 radio si të Policisë dhe 60 fishekë të kalibrave të ndryshëm, që posedoheshin pa leje.*

*Gjithashtu, në lidhje me këtë rast u shpall në kërkim shtetasi A. H., 33 vjeç, banues në Tiranë, pasi nga hetimet dyshohet se ka bashkëpunuar me babanë e tij, shtetasin M. H., për kultivimin e bimëve narkotike. Punohet për kapjen e 33-vjeçarit.*

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Elbasanit, për veprat penale "Kultivimi i bimëve narkotike", "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit", "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive" dhe "Mbajtja pa të drejtë e uniformës".

Xh.K/I.M/Shqiptarja.com

TAG: gramsh Elbasan kanabis Myrtezan Hoxha

Komento

## Komente

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

**Sondazhi i ditës:** 24 Qershor, 19:01

**A mendoni se rinumërimi i pothuajse gjysmës së votave është farsë e kotë?**

Po | Jo | I/e dyzuar

## Lajme të tjera



Përplasi për vdekje me makinë këmbësoren në Qukës-Prrenjas, arrestohet shoferi

24 Qershor, 10:34



Elbasan/ Gropat e thella karstike rrezikojnë banesat në fshatin Dëshiran! Banorët: Çdo natë e kalojmë me ankth, institucionet të veprojnë

23 Qershor, 15:43



Elbasan/ Gjendet një trup i pajetë në lumin Shkumbin nga peshkatarët lokal, Policia: Ka humbur jetën disa ditë më parë (VIDEO)

23 Qershor, 15:03




Makina përplas këmbësoren në Prrenjas, ndërron jetë 70-vjeçarja

23 Qershor, 13:57




Tiranë/ Me doza kanabisi gati për shitje, arrestohet 48-vjeçari! I kishte fshehur në një tunel pranë pallatit

23 Qershor, 10:05



Banesa në Gramsh përfshihet nga flakët, ende nuk dihen shkaqet (VIDEO)

23 Qershor, 08:48



Aksident në aksin Librazhd-Prrenjas, përplasen kokë më kokë dy automjete në Qukës! 3 persona përfundojnë të plagosur

22 Qershor, 18:20



Zjarr i madh në afërsi të varrezave të Elbasanit, flakët iu afruan edhe banesave! Zjarrfikësit e shuajnë vatrën në kohë (VIDEO)

22 Qershor, 17:10




Asgjësohen 1 mijë rrënjë kanabisi në Fier, në pranga 48-vjeçari, nën hetim i ati (EMRI)

22 Qershor, 09:46




I morën me dhunë celularin 31-vjeçarit në Elbasan, një i arrestuar dhe një në kërkim

21 Qershor, 13:07



VIDEO/ 'Asnjë lëvizje', 5 të rinjtë kapen duke trafikuar 5 kg kanabis në Valias, tentojnë t'i ikin policisë me makinë

21 Qershor, 09:40




Ekskluzive në Report Tv/ Spiunazhi i kinezëve dhe Uzina 12 e Metalurgjikut të Elbasanit

Eljan Tanini

20 Qershor, 22:15



© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje